

Dhënia e përshtypjeve/ feedback-ut

Sipas Kurt Lewin, Feedback-u/ dhënia e përshtypjeve është procesi i gjenerimit të të dhënave për të vlerësuar devijimet nga qëllimi/ synimi i dëshiruar. Në marrëdhëniet e punës, ky proces shërben për ti bërë me dije punonjësit se si perceptohet performanca e tyre dhe çfarë ndikimi kanë ata tek të tjerët. Marrja e këtij informacioni i ndihmon punëmarrësit të kuptojnë se si shihet/ vlerësohet performanca e tyre. Feedback-u në organizata hierarkike drejtohet jo vetëm drejt raporteve të drejtpërdrejta, por gjithashtu i bën me dije autoriteteve mbikëqyrëse ku dhe si arrihen synimet e tyre të drejtpërdrejta. Në këtë kontekst, me rëndësi është marrja parasysh e influencës/ ndikimit, koncept i prezantuar nga Steven Corvey.

Dhënia e feedback-ut "Kritik" në mënyrën e duhur ka një rëndësi të madhe në marrëdhënien drejtues-bashkëpunëtor dhe është një parakusht për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e saj, për dhënien e rezultateve dhe për vetë-zhvillim të vazhdueshëm. Bazuar në atë që John Gottman e etiketoi si llogaria "banka emocionale", ky proces ndjek një model me katër hapa dhe me një logjikë të caktuar për të shmangur ato që quhen "sjellje toksike"

Elementë kyç që do trajtohen gjatë trajnimit:

- Të përdorurit si menaxher të qasjes së leadershipit situacional
- Të mësuarit e stileve të ndryshme të leadershipit dhe si ti aplikoni këto stile
- Të kuptuarit e konceptit Menaxhim sipas Objektivave/ Management by Objectives – MBO (Drucker)
- Aktivitetet që duhen bërë për të arritur rezultatet
- Cilësitë që duhen përcjellë për të përmirësuar performancën
- Të kuptuarit se si lidhen feedback-u dhe influencimi
- Të mësuarit se si të jepni feedback në çështje kritike
- Të mësuarit rreth feedback-ut toksik

Metodologjia

Sesionet e trajnimit janë dizenuar të jenë interaktive. Eksperienca na ka treguar se pjesëmarrësit nxënë më shumë në aktivitetet në të cilat përfshihen aktivisht. Në një kohë të shkurtër në njëkohësisht maksimizojmë impaktin e mësimit si edhe përfshijmë personalisht në aktivitete çdo pjesëmarrës të grupit.

Target Grupi

Specialistë dhe menaxherë të cilët dëshirojnë të përmirësojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre në procesin e dhënies së përshtypjeve.

Kohëzgjatja:

2 ditë (09:00 - 17:00)

Tarifë pjesëmarrjeje:

Për t'u përditësuar

Përfshirë në çmim:

2 pushime kafe + dreka